



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 136 Prot

Tiranë, më 25.07, 2012

VENDIM Nr. 226, datë 25.07.2012

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 25.07.2012, pasi shqyrtoi "Raportin e plotësuar të sondazheve arkeologjike të kryer në sheshin e ndërtimit me adresë: **Lagjja Nr. 7, Rruga "Pano Foto", Durrës**, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik mbi bazën e kërkesës të Subjektit "LORI 2007" sh.p.k.,

VENDOSI:

- I. Të miratojë raportin e plotësuar të sondazheve arkeologjike, të përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për sheshin e ndërtimit të subjektit "LORI 2007" sh.p.k, Lagjja Nr. 7, Rruga "Pano Foto", Zona Arkeologjike "B", Durrës.
- II. Të kryhet gërmimi arkeologjik i shpëtimit i varrezës nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Durrës.
- III. Pas gërmimit të plotë arkeologjik dhe dokumentimit të varrezës, të realizohet një sondazh verifikues në shtresën poshtë nivelit të varrezës. Nëse prej tij konfirmohet rezultati i sondazheve për mosekzistencën e shtresës kulturore poshtë varrezës, të lejohet zbatimi i projektit ndërtimor.
- IV. Në përfundim të gërmimit arkeologjik të shpëtimit, të përgatitet dokumentacioni i plotë dhe raporti përfundimtar i gërmimit. Gjetjet arkeologjike të dalta gjatë gërmimit arkeologjik të shpëtimit të depozitohen pranë DRKK Durrës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

ALDO BUMÇI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI

